



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

Nr. _____ prot.

Korçë, më 03.07.2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

Date 03.07.2023

Drejtuar: *Shoqërisë "KORSEL" shpk* adresa: Korçë , Lagjja 17, Rruga Midhi Kostani,
Prane Hipotekes, Objekti Nr. 23

Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar**

Numri i procedurës **REF-71567-06-05-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës :

Objekti: **"Mirëmbajtja e varrezave publike dhe të dëshmorëve"**

Afati: **12 muaj**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike : **Date 12.06.2023, Nr.53**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Shoqëria " GRIALD " sh.p.k , NIPT J68117216C me vlerën:

2.776.493,2 (dy milion e shtateqind e shtatedhjetë e gjashtë mijë e katerqind e nentedhjetë e tre presje dy) lekë pa tvsh.

2. Shoqëria " ED KONSTRUKSION " sh.p.k , NIPT K61625001L me vlerën:

3.385.789,80 (tre milion e treqind e tetëdhjetë e pesë mijë e shtateqind e tetëdhjetë e nente presje tetëdhjetë) lekë pa tvsh.

3. Shoqëria "KORSEL" sh.p.k , NIPT J64104124G, me vlerën:

3.699.136,5 (tre milion e gjashtëqind e nentedhjetë e nente mijë e njëqind e tridhjetë e gjashtë presje pesë) lekë pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë s'kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

I. Shoqëria “ GRIALD ” sh.p.k , NIPT J68117216C per arsye se:

1. Ofertuesi nuk përmbush kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit,shtojca 8,kriteret e vecanta te kualifikimit,pika 1.b **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Konkretisht ofertuesi nuk ka dorëzuar sigurim oferte.

2. Ofertuesi nuk përmbush kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit,shtojca 8 kriteret e vecanta të kualifikimit, **Aftësitë teknike dhe profesionale, pika ”2.2.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me Licensë për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane (kodi III.2.B)”**

Ofertuesi ka dorëzuar licencën e kërkuar me sipër në emrin e tij. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit ka deklaruar se për plotësimin e këtij kriteri do të mbështetet tek shoqëria “Leal”sh.p.k dhe gjithashtu ka bashkëlidhur licencën kodit III.2B të kësaj shoqërie.

-Në ,shtojcën 8, kriteret e përgjithshme të kualifikimit, përcaktohet se : *Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

Ofertuesi nuk ka dorëzuar një angazhim me shkrim midis tij dhe shoqërisë Leal sh.p.k për këtë qëllim

-Në, shtojcën 9 të dokumentave të tenderit, përcaktohet se:

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Ofertuesi nuk ka dorëzuar formular vetëdeklarimi nga subjekti mbështetës.

2. Shoqëria “ ED KONSTRUKSION ” sh.p.k , NIPT K61625001L per arsye:

1. Në nenin 26 të VKM Nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar , pika 6 parashikohet shprehimisht se : “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.” Me shkresën Nr 4782 Prot date 19.06.2023 i është kërkuar ofertuesit të paraqesë dokumentacionin si më poshtë :

a) dokumentet e paraqitura si pjese e ofertes ne rruge elektronike, te cilat ne kohen e dorezimit prane autoritetit kontraktor duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre.
b) dokumentet mbeshtetese ne origjinal ose nje kopje te noterizuar te tyre per vetedeklarimet e

dhena ne formularin permbledhes te vetedeklarimit.

Dokumentacioni duhet te dorezohej brenda 5 diteve nga data 19.06.2023.

Ofertusi s'kualifikohet duke qene se nuk ka dorezuar asnje nga dokumentat e kerkuara.

* * *

Duke iu referuar procedures se lartpermendur, informojme **Shoqerine "Korsel"shpk adresa: Korçe , Lagjja 17, Rruga Midhi Kostani, Prane Hipotekes, Objekti Nr.23**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **3.699.136,5 (tre milion e gjashteqind e nentedhete e nente mije e njeqind e tridhete e gjashte, presje pese) lekë pa tvsh**, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedures se prokurimit.

Me publikimin e ketij njoftimi, fillojne afatet e ankimit sipas percaktimeve ne nenin 110 te Ligjit Nr. 162/2020, date 23.12.2020 "Per Prokurimin Publik".

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
SOTIRAQ FILO**